



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 534/1 Prot.

Maliq, më 02 / 11 /2020

Lënda: Njoftim

Drejtoria e teknologjisë së informacionit dhe marrëdhënieve me publikun

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, gërma (a), në ligjin nr. 8308, dt. 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15 pika, neni 19; Udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, neni 11 dhe Urdhrit të Kryetarit Nr. 499, Datë 02.11.2020 po ju dërgojmë njoftimin për shpallje për “Përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Maliq”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu



Nr. 133 Prot
Dt. 03.11.2020

Datë 02.11.2020

NJOFTIM

“Për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Maliq”

Bazuar në ligjin nr. 8308, dt. 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15 pika, neni 19; Udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", të ndryshuar, neni 11; urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Maliq Nr.499, datë 02.11.2020, "Për përzgjedhjen e subjektit/subjekteve që do të liçencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Maliq" :

Bashkia Maliq njofton zhvillimin e konkursit për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve si më poshtë:

NR.	LINJA	Oraret
1.	Podgorie- Pogradec- Podgorie	Nisja: Kthim: 09:30 - 10:30 11:30 - 12:30 13:30 - 14:30 15: 30 - 16:30

Subjekti fizik ose juridik duhet të disponojë automjete të përshtatshme për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe duhet të dorëzojë pranë Bashkisë Maliq dokumentacionin për pjesëmarrjen në konkurs në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5627, dt. 18.11.2016, të ndryshuar, si më poshtë:

- a. Kërkesa.
- b. Formulari i autodeklarimit (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- c. Vërtetimi nga Gjykata (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- d. Vërtetimi nga Prokuroria (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë).
- e. Dokumentacioni i kredibilitetit bankar.
- f. Çertifikata e kompetencës profesionale në transportin rrugor (në rast se subjekti disponon më shumë së një mjet).
- g. Çertifikata e regjistrimit dhe ekstrakti i regjistrit tregëtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.B. (me seli në teritorin e Bashkisë Maliq)

- h. Leja e qarkullimit (për çdo autobus).
- i. Çertifikata e kontrollit teknik (për çdo autobus).
- j. Akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve (për çdo autobus).
- k. Çertifikata e kalibrimit të tahografit (për çdo autobus).
- l. Kontrata për sigurimin e automjetit (për çdo autobus).
- m. Kontrata për sigurimin e pasagjerëve (për çdo autobus).
- n. Leja e drejtimit.
- o. Çertifikata e Aftësisë Profesionale.
- p. Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij).
- q. Kontrata me agjensinë për transport udhëtarësh brenda vendit.
- r. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, mbi kryerjen e pagesës të taksave dhe tarifave vendore (për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në periudhën e mëparshme).

Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje e noterizuar.

Dokumentacioni të dorëzohet pranë Bashkisë Maliq, deri në datën 17.11.2020

Për informacion më të detajuar subjektet e interesuara mund të drejtohen pranë Bashkisë Maliq.